

PËR	<b>ORGANIN SHQYRTUES TË PROKURIMIT</b>
NGA	<b>3P sh.p.k.</b> një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me numër unik identifikues 810842303 dhe seli në: Rruga “Ahmet Krasniqi”, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, e cila sipas autorizimit përfaqësohet nga Shoqëria e Avokatëve Sejdiu & Qerkini sh.p.k. <sup>1</sup> , me seli në: Lagja Veternik, Kompleksi Banesor EXDC3, Blloku 10, Kati 6, Nr. 18, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.
DATA	25 mars 2024
LËNDA	<b>ANKESË ndaj Vendimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, datë 20.03.2024.</b>

## I. Hyrje

Autoriteti kontraktues, ka hapur tenderin me titull “Shërbimet Postare Diplomatike – RITENDER”, i cili identifikohet me numër të prokurimit: 216-23-13152-2-1. Në këtë tender të hapur kishte aplikuar edhe 3P sh.p.k. (këtu e tutje “Parashtruesi”).

Me datë 08.02.2024, Autoriteti Kontraktues, kishte marr vendimin me anë të së cilit si fitues të tenderit kishte shpallur Parashtruesin, i cili njëkohësisht ishte dhe është tenderuesi me çmimin më të volitshëm.

### **Provë 1: Njoftimi mbi vendimin dhe Letra standarde për tenderuesin e suksesshëm, datë 05.02.2024**

I pakënaqur me këtë vendim dhe me njoftimin për eliminim, operatori ekonomik A.L.Dushi sh.p.k., paraqet kërkesë për rishqyrtim ndaj letrës së drejtuar asaj si tenderues i pasuksesshëm.

Autoriteti kontraktues, duke vendosur sipas kërkesës së operatorit ekonomik A.L.Dushi sh.p.k., me datë 13.02.2024, merr vendimin me anë të së cilit aprovon si pjesërisht të bazuar kërkesën e këtij operatori dhe tenderin e kthen në rivlerësim.

### **Provë 2: Vendimi i Autoritetit Kontraktues, datë 13.02.2024**

Duke vendosur në procedurë të rivlerësimit, Autoriteti kontraktues, me datë 13.03.2024, merr vendimin me anë të së cilit, fitues të tenderit e shpall operatorin ekonomik A.L.Dushi sh.p.k., ndërsa Parashtruesi është njoftuar se në këtë tender është tenderues i eliminuar.

### **Provë 3: Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues**

<sup>1</sup> Shih të bashkangjitur Autorizimin dhënë Shoqërisë së Avokatëve Sejdiu & Qekini sh.p.k

Parashtruesi nuk pajtohet me Letrën e Autoritetit Kontraktues (prova 3), dhe brenda afatit ligjor, kishte paraqitur kërkesën për rishqyrtim të letrës standarde.

#### **Provë 4: Kërkesa për rishqyrtim**

Për këtë pjesë duhet paraqitur një sqarim, Parashtruesi gabimisht, kërkesën për rishqyrtim të letrës standarde, e kishte ngarkuar tek pjesa e dokumenteve shtesë. Parashtruesi, përveç që kishte vërejtur vetë këtë gabim të tij, i njëjti ishte bërë me dije edhe nga Autoriteti Kontraktues, i cili i dërgon një email, me njoftimin se kërkesa nuk është paraqitur konform rregullores.

#### **Provë 5: E-mail nga autoriteti kontraktues 15.03.2024**

Pas kësaj, Parashtruesi ditën e njëjtë, paraqet kërkesën për rishqyrtim sipas rregullores dhe sistemit të E-Prokurimit dhe për këtë çështje njofton edhe Autoritetin e Kontraktues (prova 5), por që nga i njëjti më nuk merr asnjë përgjigje. Pas kësaj, Parashtruesi natyrisht se duke konsideruar se të drejtën e tij për paraqitjen e mjetit juridik e ka bërë në mënyrë të rregullt, pret përgjigjen e autoritetit kontraktues.

#### **Provë 6: Foto e ekranit nga sistemi i E-Prokurimit të Parashtruesit**

Autoriteti kontraktues pas gjithë informatave që kishte, lidhur me atë se kërkesa njëherë ishte dorëzuar si dokument shtesë, por që pas njoftimit është dorëzuar edhe sipas mënyrës siç është dashur të dorëzohet, me datë 20.03.2024, merr vendimin e pa identifikuar, me anë të së cilit vendos për kërkesën e dorëzuar si dokument shtesë? Pra, Autoriteti kontraktues, ka vendosur për një kërkesë të cilin edhe vetë e ka shpallur si jo të rregullt, ndërsa ka lënë pa trajtuar kërkesën e cila është dorëzuar konform rregullores dhe sugjerimit të Autoriteti Kontraktues (prova 5).

#### **Provë 7: Vendimi i Autoritetit Kontraktues, datë 20.03.2024**

Parashtruesi duke mos u pajtuar me vendimin e autoritetit kontraktues, brenda afatit ligjor, paraqet këtë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit, përmes së cilës konteston në tërësi vendimin e autoritetit kontraktues.

## **II. Baza Juridike**

Si bazë juridike, për hartimin dhe paraqitjen e kësaj kërkesë shërbeu:

- Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (këtu e tutje “LPP”);
- Ligji Nr. 04/L-237 për ndryshmin dhe plotësimin e Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (këtu e tutje “LPP I”);
- Ligji Nr. 05/L-068 për ndryshmin dhe plotësimin e Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (këtu e tutje “LPP II”);
- Ligji Nr. 05/L-092 për ndryshmin dhe plotësimin e Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (këtu e tutje “LPP III”);

- Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (këtu e tutje “LPPA”);
- Rregullore Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (këtu e tutje “Rregullorja”).

### III. Arsyetimi

LPP II në Nenin 61 përmes së cilit ka riformuluar paragrafët 1 dhe 2 të Nenit 109 të LPP-së, parasheh se:

*“1. Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.*

*2. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.”*

#### 3.1. Kërkesa është dorëzuar në mënyrë të rregullt

Në pjesën hyrëse të kësaj Ankese, Parashtruesi me anë të provave (4,5,6) ka dëshmuar se ka dorëzuar në mënyrë të rregullt kërkesën për rishqyrtim. Këtë dorëzim të rregullt dhe sipas udhëzimeve të Autoritetit Kontraktues (prova 5), Parashtruesi e kishte bërë në ditën e njëjtë. Pra, Parashtruesi me datë 15.03.2024, kishte pranuar emailin (prova 5) nga Autoriteti Kontraktues dhe në të njëjtën datë 15.03.2024 (Prova 6) kishte paraqitur Kërkesën ashtu siç edhe duhet.

Andaj, në bazë të atyre që u cekën më lartë, vërtetohet se Parashtruesi Kërkesën për Rishqyrtim e kishte paraqitur konform dispozitave ligjore dhe poashtu vërtetohet se Autoriteti Kontraktues gjatë marrjes së vendimit, nuk ka shqyrtuar Kërkesë për Rishqyrtim por ka shqyrtuar dokumentin shtesë.

Nga provat e lart cekura, poashtu vërtetohet fakti se Parashtruesi rregullimin e dorëzimit të rregullt e ka bërë brenda afatit të paraparë në Rregullore.

#### 3.2. Vendimi i paarsyetuar

Neni 48 i LPPA-së, parasheh se:

*“1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ.  
Arsyetimi përmban:*

*1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës;*

- 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi;
  - 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave;
  - 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyeën pse është e zbatueshme në rastin konkret;
  - 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve;
  - 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim.
2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.”

Autoriteti Kontraktues, njëkohësisht shkalla e dytë e këtij organi, në bazë të Kërkesës për Rishqyrtim të Parashtruesit është thirrur që të vendos lidhur me pretendimet e tij dhe njëkohësisht që të shqyrtojë edhe ligjshmërinë e vendimit të shkallës së parë.

Le të rikujtojmë atë se çfarë është thënë në letrën ndaj së cilës Parashtruesi kishte paraqitur Kërkesën për Rishqyrtim (prova 3). *“Nuk është përgjigjur kërkesës së AK për sqarim të çmimeve Abnormalisht të ulëta”*

Pra, përmes Kërkesës për Rishqyrtim, Parashtruesi ka prezantuar provat dhe argumentet se si ai ka të drejtë që gjatë gjithë procedurës sa çështja zhvillohet pranë Autoritetit Kontraktues, që të paraqes sqarime për kërkesat e AK.

Deri këtu u kuptua se me çfarë ka pasur të bëjë letra për tenderuesin e eliminuar dhe me çfarë ka pasur të bëjë ankesa.

Në anën tjetër AK, në arsyetimin e vendimit të saj, flet për krejt diçka tjetër. Në paragrafin e fundit të faqes 2 të vendimit të ankimit ceket se: *“Letër standarde për sqarime shitesë për kërkesën e kapacitetit teknik...”* Vazhdon në faqe 3 *“Duhet cekur se OE-ik është deklaruar lidhur me kërkesën e sqarimeve për AWB (çdo shtet nga tri dëshmi) por që edhe pas sqarimeve të dorëzuara nga ana e OE-ik, nuk e plotësojnë kërkesën e Autoritetit Kontraktues (sepse shumica prej tyre janë pas datës së hapjes së ofertave).*

Nga paragrafi i mësipërm vërtetohet se shkalla e dytë e Autoritetit Kontraktues, ka vlerësuar çështje / dokumente që nuk kanë pasur fare të bëjnë me ankesën dhe të cilat fare nuk janë trajtuar nga ana e shkallës së parë të AK. Me këtë vlerësim, AK na jep të besojmë se Parashtruesi është eliminuar nga tenderi edhe për shkak se sqarimi për kapacitet teknik nuk ka qenë në rregull. Mirëpo ky vlerësim është krejtësisht në kundërshtim me ligjin, kjo për shkak se shkalla e parë e AK nuk e ka cekur një fakt të tillë dhe rrjedhimisht Parashtruesit nuk është dhënë e drejta ligjore dhe kushtetuese që të paraqes mjetin e rregullt juridik për çdo shkelje që atë e ka eliminuar. Tutje, kjo mënyrë e vendosjes është edhe kundër parimit të vendosjes në dy shkallë dhe se faktit se asnjëherë shkalla e dytë nuk vendos për një çështje që nuk është trajtuar në shkallës të parë.

Sa i përket pjesës tjetër (kërkesë për sqarim në lidhje me çmimet), shkalla e dytë e AK-së, jo vetëm që nuk ka dhënë sqarime në lidhje me pretendimet e Parashtruesit, por të njëjtat as nuk i ka përmendur në arsyetimin e saj.

Rrjedhimisht, arsyetimi i vendimit të atakuar me këtë ankesë, nuk përmban asnjë nga pjesë e parapara në paragrafin 1 të Nenit 48 të LPPA-së, sepse në të nuk është paraqitur kërkesa e palës, nuk janë shpjeguar rrethanat faktike, nuk janë cekur faktet vendimtare, mungon baza ligjore, nuk është arsyetuar mospranimi i pretendimeve të palëve etj etj.

Përveç mungesës në arsyetim, vendimi i ankimuar ka dalë edhe nga objekti i kontestit, duke analizuar çështje për të cilat Parashtruesi nuk ka qenë në dijeni se kanë ekzistuar dhe për të cilat Parashtruesi nuk ka pasur as mundësi të jap pretendimet e tij.

Andaj, bazuar në të gjitha këto, arsyetimi i vendimit dhe vendimi në tërësi, rezulton të jetë tejet kontradiktor në vetë vete dhe në raport me pikat e dispozitivit dhe një vendim i tillë nuk mund të qëndrojë. Këtë e përkrah edhe paragrafi 2 i Nenit 48 të LPPA-ve i cili parasheh se:

*“Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.”*

Tutje, si mundet që në pikat e dispozitivit të refuzohet një Kërkesë, e cila është inicuar bazuar në një letër standarde, ndërsa në arsyetimin e atij refuzimi të flitet për çështje që fare nuk janë paraparë në letrën standarde?? Tërësisht e pakuptimtë!

### **3.3. Konstatim i gabuar i gjendjes faktike**

Ashtu siç edhe është cekur në pjesën hyrëse si dhe në pikën 3.1, Parashtruesi Kërkesën për Rishqyrtim e kishte paraqitur konform Rregullores dhe konform rekomandimit të Autoritetit Kontraktues. Andaj, duke marrë parasysh këtë, nga përfundimi i AK-së se *“Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa nuk është e lejuar sepse OE 3p sh.p.k ka dorëzuar një kërkesë përmes funksionit “dorëzim i dokumenteve shitesë”...”* vërtetohet se nga pjesa e cituar e cila gjendet krejt në fillim të arsyetimit, shihet se AK vendimin për refuzim të Kërkesës së Parashtruesit e ka marrë pas konstatimit të gabuar të gjendjes faktike.

Konstatim të gabuar të gjendjes faktike kemi edhe tek kërkesa për sqarim që lidhet me kapacitetin teknik.



### 3.4. Mohimi i të drejtës për ankesë

Me vendimi e tij, organi i shkallës së dytë ka vendosur në mënyrë meritore dhe ai vendim është arsyetuar/mb;shitetur edhe me pjesën e letrës për sqarime shtesë për kërkesën e kapacitetit teknik. Siç është cekur edhe më lartë, kjo pjesë nuk ka qenë e shfaqur në asnjë pjesët të shqyrtimeve të mëhershme. Andaj, me vetë faktin se kjo çështje në mënyrë të kundërligjshme është ngritur nga AK në shkallë të dytë, Parashtruesit i është pamundësuar e drejta që për këtë pretendim të ri të AK-së, të paraqes mjetin juridik të ankesës, mjet i cili është i garantuar me kushtetutë dhe ligje të aplikueshme.

### IV. Përfundimi dhe Kërkesa

Bazuar në dispozitat ligjore, provat dhe argumentet e ofruara, vërtetohet se vendimi i datës 20.03.2024 i Autoritetit Kontraktues, është vendim i paarsyetuar, kontradiktor, i marrë pas konstatimit të gabuar të gjendjes faktike si dhe vendim me anë të së cilit Parashtruesit, duke vlerësuar një pjesë të pavlerësuar më parë i mohohet e drejta për ankesë. Andaj, bazuar në të gjitha këto, Parashtruesi, Organit Shqyrtues të Prokurimit me respekt i propozon të bie këtë:

### VENDIM

- I. **APROVOHET** Ankesa e 3P sh.p.k e paraqitur ndaj Vendimit të Autoritetit Kontraktues Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, datë 20.03.2024, si e **BAZUAR**;
- II. **ANULOHET** Vendimi i Autoritetit Kontraktues Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, datë 20.03.2024, si i **KUNDËRLIGJSHËM**;
- III. Aktiviteti i Prokurimit “Shërbimet postare Diplomatike – RITENDER” **KTHEHET NË RIVLERËSIM** pranë Autoritetit Kontraktues Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës.

*Ankesa e hartuar dhe paraqitur me respekt nga:*

*Shoqëria e Avokatëve  
Sejdiu & Qerkini sh.p.k.*

*Avokat Burim Azemi*



Prishtinë, 25 mars 2024

"3P" SH.P.K., e regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës, me numër unik identifikues 810842303, me seli në Rr. Ahmet Krasniqi, Prishtinë-Republika e Kosovës, jep këtë:

### AUTORIZIM

Me anë të së cilës autorizohet Shoqëria e Avokatëve, "Sejdiu&Qerkini" SH.P.K., me adresë në Lagjen Veternik, Kompleksi Banesor EXDC 3, Biloku 10, Kati 6, Nr.18, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, që përmes Korab R. Sejdiu, Artan Qerkini, Miranda Haxhiu, Blinera Osmani, Taulant Q. Hajdari, Burim Azemi, Kaltrina Kodraliu, Dior Zhuri, dhe Lea Meraku, të përfaqësojnë Autorizim-dhënësen në konteste civile, komerciale, administrative, përmbarimore, në Gjykatat e Republikës së Kosovës, në të gjitha instancat e saja, në agjencitë e pavarura dhe në organet administrative të Republikës së Kosovës.

Të autorizuarit kanë të drejtë të ndërmarrin të gjitha veprimet juridike për të zgjidhur çështjet kontestuese, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar, në hartimin, nënshkrimin dhe paraqitjen e padisë dhe parashitësive të tjera, lidhjen e ujdisë gjyqësore, paraqitjen e mjeteve juridike të zakonshme dhe të jashtëzakonshme, paraqitjen e propozimit për përmbarim, të kërkojnë zbatimin e masave të përkohshme, dhe atë pranë të gjitha instancave gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në Republikën e Kosovës.

Ky autorizim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe vlen deri sa të revokohet nga Autorizim-dhënësi.

AUTORIZIMDHËNËSI:

"3P" Sh.P.K.

  
Shqipe Dushi Peja  
Drejtoreshë Menaxhuese



Prishtinë, 28 shtator 2022



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës / Ministarstvo Inostranih Poslova i Dijaspóra / Ministry of Foreign Affairs and Diaspora

**NJOFTIM MBI VEDNDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: Shërbimet postare Diplomatike-  
RITENDER

Nr. i prokurimit <sup>1</sup>	216-23-13152-2-1-1
-------------------------------	--------------------

Radhë	Lënda / grupi: Shërbimet postare Diplomatike- RITENDER	Çmimi total i ofertës(me TVSH) POENTIM
1.	3 P SH.P.K. Ahmet Krasniqi 254, Prishtine 601168356	233.40
2.	A.L. DUSHI SH.P.K. KOSTA NOVAKOVIQ C4/2 LAM.B NR.5, PRISHTINE 811250860	1,304.55


Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

AK shpërblen me kontratë 3 P SH.P.K. me çmim me të lirë të përgjegjshëm prej 233.40.

Data: 05.02.2024

Emri dhe mbiemri i ZPP:

Kaltrina Dalipi



<sup>1</sup> Da se izveštava u svakom dokumentu ili zahtevu u vezi sa aktivnost nabavke.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës / Ministarstvo Inostranih Poslova i Diaspora /  
Ministry of Foreign Affairs and Diaspora

**Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm<sup>1</sup>**

MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME, Rr. Luan Haradinaj Ndertesa e MPJ-së 10000  
PRISHTINË

3 P SH.P.K.

Nr i Prokurimit	216-23-13152-2-1-1
-----------------	--------------------

**Titulli: Shërbimet postare Diplomatie-RITENDER**

I/e nderuar(a) [Z/Znj]V,

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Kemi kënaqësinë të ju njoftojmë se ju keni dorëzuar [tenderin me çmimin më të ulët] si përgjigje ndaj [njoftimit të kontratës] për aktivitetin e prokurimit të lartcekur.

Juve ju është dhënë kontrata me çmimin e saktësuar në tenderin tuaj 233.40(çmim me poentim) dhe në pajtim me afatet dhe kushtet e dosjes së tenderit.

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimit të intervalit, gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.

Me respekt,

<sup>1</sup> Kjo letër është për ofertuesin të cilit i është dhënë kontrata



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës / Ministarstvo Inostranih Poslova i Dijaspóra / Ministry of Foreign Affairs and Diaspora

**Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm <sup>1</sup>**

MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME, Rr. Luan Haradinaj Ndertesa e MPJ-së 10000 PRISHTINË

A.L. DUSHI SH.P.K.  
KOSTA NOVAKOVIQ C4/2 LAM.B NR.5, PRISHTINE  
811250860

Nr. i prokurimit:	216-23-13152-2-1-1
-------------------	--------------------

Titulli: Shërbimet postare Diplomatiqe-RITENDER

U/e nderuar(a) [Z/Znj]

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kritereve të dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe ne Dosjen e Tenderit.

Me keqardhje ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj nuk qe i suksesshëm, ngase tenderi juaj *[nuk qe tenderi me çmimin më të ulët]* në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ju informojmë se kontrata i është dhënë 3 P SH.P.K. për një shumë prej 233.40(çmim me poentim).

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimin e intervalit, *gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.*

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

Njoftimi i dhënies së kontratës është i publikuar ne platformën elektronike.

Me respekt,

<sup>1</sup> Kjo letër u drejtohet tenderuesve që i kanë plotësuar të gjitha kërkesat e autoritetit kontraktues, të paraqitura në njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit, por të cilëve nuk u është dhënë kontrata, ngase tenderët e tyre nuk qenë nga më të mirët sipas kriterit për dhënien e kontratës.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës*  
*Ministarstvo Inostranih Poslova i Dijaspore - Ministry of Foreign Affairs and Diaspora*

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik A.L.Dushi Shpk të datës 12.02.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 08.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet postare Diplomatike-RITENDER" me nr. të prokurimit 216-23-13152-2-1-1, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. APROVOHET SI PJESËRISHT E BAZUAR** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik A.L.Dushi Shpk. e datës 12.02.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 08.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet postare Diplomatike-RITENDER" me nr. të prokurimit 216-23-13152-2-1-1.

**II. Autorizohet** autoriteti kontraktues - Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të kthejë në Rivlerësim procedurën lidhur me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.

**III. NJOFTOHET** operatori ekonomik A.L.Dushi Shpk si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

**IV. Vendimi hyn** në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

**I.** Operatori ekonomik A.L.Dushi Shpk (tutje "parashtruesi") me datë 12.02.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 08.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet postare Diplomatike-RITENDER" me nr. të prokurimit 216-23-13152-2-1-1.

- II. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

**Pretendimi nr.I i parashtruesit është cituar si në vijim:**

- Fillimisht OE 3P nuk ka përmbushë kërkesën e paraparë me Nenet 9.1 dhe 9.2 të FDT të cilat i referohen kërkesës " Dëshmi (AWB) ku dëshmohet që për disa shtetet të caktuara Evropë (Gjermania, Franca) ka bërë realizimin e dërgesave për 48-72 orë, Afrikë (2 shtete) ka bërë realizimin e dërgesave për 48-72 orë dhe SHBA& Canada ka bërë realizimin e dërgesave për 36-48 orë. Dmth për çdo shtet nga 3 dëshmi (origjinal).
  - Fillimisht nga dosja e tenderit është efidente fakti që OE nuk ka dorëzuar dëshmi të kërkuara për zonën e Afrikës ku në dokumentacionin e dosjes shihet që për këtë Zonë ka dorëzuar vetëm 1(një) dëshmi për shtetin e Senegalit në vend të 3 dëshmimeve të kërkuara në FDT.
  - Gjithashtu nga dëshmitë e dorëzuara në emër të AWB-ave për Zonat dhe 4/3 F02 Formulari Standard për rishqyrtim të vendimit në AK kohën e realizimit të kohës së dorëzimit, del që 40% të numërave identifikues të dërgesave të cilave i referohet OE në shkresën sqaruese nuk mund të identifikohen në sistemin online të operatorit, fakt i cili tregon që pretendimet e operatorit që dërgesat në fjalë janë përfunduar brenda afatit të kërkuar nuk mund të dëshmohen e as të konfirmohen nga askush, ky fakt në mënyrë automatike dëshmon që OE 3P Shpk nuk e ka përmbushë kushtin dhe kërkesën e FDT 9.1 dhe 9.2 përmes numërit të dëshmimeve të kërkuara për secilën zonë në FDT.
  - Respektivisht nëse provojmë që ti konfirmojmë të dhënat për dërgesat në shtetet si në Zvicër (numëri i dërgesës 2802852850), Arabi Saudite (numëri i dërgesës 2802873264), Senegal (numëri i dërgesës 4188756176), SHBA (numëri i dërgesës 4461539121), Gjermani (numëri i dërgesës 6424503024), të njejtat dërgesa e as numërat e dërgesave nuk identifikohen dhe nuk mund të dëshmohen në sistem nëse janë dërgesat operatorit dhe nëse të njejtat janë kryer në suaza të afateve të kërkuara në dosje. Rrjedhimisht, në pamundësi të identifikimit të informatave në fjalë, del që OE nuk ka përmbushë kërkesën 9.1 & 9.2 të sipërpërmendur.
  - Njoftojmë AK që në procesin e prokurimit nr. 216-23-7668-2-2-1, për shërbimin e njejtë si lënda e këtij procesi të prokurimit i emëruar si "Shërbime postare Diplomatiçe" Ri-tender i cili ka është mbajtur vitin e kaluar muajin Gusht, 2023, respektivisht me datën 14.08.2023 AK e ka anuluar procesin e prokurimit ku Kompania jonë ka qenë fituese duke u thirrë në mungesë të përmbushjes së kushteve teknike, respektivisht të kërkesës lidhur me dëshmitë e AWB-ave. Kopja e vendimit të AK do të jetë pjesë e përbërse e kërkesës në fjalë. Si palë e interesit në këtë proces të prokurimit mendojmë që i njejtë standard i eliminimit të tenderuesit të papërgjigjshëm do të duhet të aplikohet edhe në rastin e procesit të prokurimit në fjalë ndaj OE 3P Shpk.
- Pastaj shumë qart shihet nga dosja e tenderit që OE në dosjen e dorëzuar të tenderit e cila i referohet kërkesës në pikën 9.1&9.2 të FDT e cila i referohet të dhenave për kontratat e përfunduara dhe referencave relevante për të njejtat, shihet që OE nuk ka dorëzuar asnjë referencë në përputhje me kërkesën për punët e kryera gjatë periudhës tri vejqare para publikimit të njoftimit për kontratë. Gjithë referencat e dorëzuara janë nga periudha më e vjetër se tri vitet e fundit (gjithë referencat e dorëzuara janë të viteve 2009 deri 2018) asnjëra nuk është brenda afatit të



kërkuar në FDT. Përmes kësaj mund të konkludojmë që OE nuk ka arritë të përmbushë as këtë kërkesë të FDT-ës.

### **Sa i përket pretendimit të parashtruesit**

Në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale : DESHMIA

“Dëshmi (AWB) ku dëshmohet që për disa shtete të caktuara p.sh Evropë (Gjermania, Franca) ka bërë realizimin e dërgesave për 24 orë, Azi (2 shtete) ka bërë realizimin e dërgesave për 48-72 orë, Afrike (2 shtete) ka bërë realizimin e dërgesave për 48-72 orë dhe SHBA & Canada ka bërë realizimin e dërgesave për 36-48 or, D.m.th. për çdo shtet nga 3 dëshmi (original)”

Zyrtari Përgjegjës I Prokurimit ka konstatuar se Komisioni I vlerësimit ka mundur të kërkojë sqarime lidhur me këtë pretendim (për çdo shtet nga 3 dëshmi), andaj edhe Zyrtari përgjegjës I prokurimit konstaton se pretendimi I juaj është I bazuar .

Ndërsa lidhur pikat tjera të këtij pretendimi ZPP ju njofton se gjatë vlerësimit komisioni ka vlerësuar dëshmitë e kërkuara sipas kërkesës së paraqitur në Dosje dhe Njoftim dhe asnjëherë duke kërkuar konfirmime tjera të cilat nuk janë pjesë e kërkesave në Dosje.

Pika tjetër ku ceket se AK ka vlerësuar me standard të dyfishta ju njoftoj se nuk bëhet fjalë për aktivitetin e njëjtë, gjithashtu keni mundur të shfrytëzoni të drejtën tuaj për kërkesë për rishqyrtim dhe ankesë në rastet konkrete.

Po ashtu lidhur me Dëshmitë e përfundimit të shërbimeve të ngajshme, AK ju njofton se Komisioni I vlerësimit ka kërkuar sqarime për të njëjtat, andaj edhe ka rekomanduar për dhënie duke u bazuar në sqarime të dorëzuara nga OE-ik dhe menagjeri I kontratës.

### **Pretendimi nr.II i parashtruesit është cituar si në vijim:**

AK përmes Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues-Leter standarde për tenderuesin e suksesshem i lëshuar nga AK më dt.08.02.2024 ka bërë shkelje të drejtëpërdrejtë të Nenit 60, pika 1.1 ku ka shpallur si tender fitues një tender i cili është i papërgjegjshëm, duke qenë se i njëjti nuk ka përmbushë kërkesat kyqje të kushteve që OE i cili ka ofertu ka qenë i obliguar ti përmbushë në procesin e vlerësimit.

- Neni 61 të LPP në mënyrë të qartë parashih trajtimin e Tenderëve Jo- Normalishtë të Ulta. Sipas çmimeve të cilat i ka siguruar OE nga AK me datën 09.02.2024, më saktësisht Listës së Çmimeve të fituesit të shpallur me Njoftimin e AK të dt.08.02.2024, shihet shumë qartë që Kompania e shpallur si fituese 3P Sh.p.k. ka vendosur çmime jashtëzakonishtë të ulëta dhe çmime manipulative për të gjithë pozicionet e kërkuara në Ofertën Financiare.

Çmimet e ofertuara nuk janë çmimet reale të tregut, dhe i njëjti Operatorë ka bërë shkelje të rëndë duke ofertuar me çmime jashtëzakonishtë të ulëta dhe manipulative si ato të ndara sipas Zonave, por veçanërishtë tek ofertimi i çmimeve tek peshat, ku çmimi i ofertuar tek peshat më të mëdha është më i ultë se sa tek peshat më të vogla. Në praktikën e shërbimit të postës ky fakt tregon që tendenca e operatorit është diskriminimi, abuzimi dhe oferta manipuluese për shërbimet e MPJD, dhe se i njëjti nuk mund ti përmbushë kërkesat e procedurës së prokurimit për AK.

- Me çmimet e ofertuara në mënyrë të drejtëpërdrejtë përmes Nenit 61.6 të Ligjit Nr. 05/L -068 është shkel Neni 3&4 i Rregullorve të KRRP-ës B57, ku shumë qartë përcaktohen rastet se kur një tender mund të trajtohet si i Jo- Normalishtë i Ultë. Çmimet e ofertuara nga OE 3P Sh.p.k. janë



më shumë se 30% më i ulët se çmimi i tenderuesit të dytë të përgjegjshëm dhe çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi të tenderit të dytë. OE 3P Shpk me çmimet e ofertuara në asnjë mënyrë nuk mund të ekzekutojë kontratën për shërbimin e transportit ajror për qëllimet e kërkuara në dosjen e prokurimit me numër 216-23-13152-2-1-1. Nga dosja dhe dokumentacioni sqarues i kërkuar nga AK del që AK nuk ka apliku Nenet ligjore të cilat e obligojnë AK të vepron kur ka një ofertë e cila është dorëzuar me çmime Jo- Normalisht të ultë.

- Me shkeljet e Neneve 61 të LPP dhe Neneve 3&4 të Rregullave B57 të KRRP-ës, AK me Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues-Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm që është bërë më dt.08.02.2024 ka shkel drejtëpërdrejtë edhe Nenin 7 të LPP si dhe Ligjin nr.03/L-229 për 6/3

F02 Formulari Standard për rishqyrtim të vendimit në AK Mbrojtjen e Konkurrencës.

Neni 7 i LPP-së në mënyrë shumë të qartë thekson obligimin e AK të jetë jodiskriminues ndaj asnjërit tenderues, ku në këtë rast shihet që i njëjti Nen nuk është respektu dhe është keqpërdorë dhe është abuzu nga ana e OE 3P Shpk me pozitën dominuese të cilën pozitë Kompania 3P Sh.p.k. ka pas gjatë kësaj periudhe, sepse kjo kompani e ka këtë kontratë me MPJD dhe të njëjtën e përmbushë më shumë se 10 (dhjetë) vite me rradhë dhe ka monopolin e shërbimit të postës së shpejtë diplomatike.

Ky fakt e ka diskriminuar Kompaninë tonë ndaj qfarëdo çasje të cilën OE 3P Shpk i ka pas gjatë kohëzgjatjes së operimit me MPJD e të cilin mundësi në si kompani konkurrese nuk e kemi pas, mirëpo ne kemi ofertu në përputhje dhe sipas kërkesës dhe të dhënave në FDT - Gjithëashtu Ligji nr. 03/L-229 e parasheh që abuzimi i pozitës dominuese i një ose më shumë ndërmarrjeve në tregun relevant është i ndaluar veçanërisht në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthor vendos çmimin jo real të blerjes apo shitjes, ose kushte tjera të pa drejta tregtare.

- Gjithëashtu me veprimet e sipërpërmendura AK ka shkelj edhe Ligjin mbi Shërbimet Postare nr. 06/L-038, respektivisht Nenet 4 dhe 29. Neni 4, pika 1 parasheh parimet e përgjithëshme "ofrimi dhe sigurimi i shërbimeve postare bëhet në tërë territorin e Republikës së Kosovës nga personat fizik dhe juridikë mbi bazën e parimeve të ligjshmërisë, mos diskriminimit, objektivitetit dhe transparencës". Përderisa Neni 29, pika 3 i të njëjtit Ligj parasheh që ".....ofruesit e shërbimit universal postar janë të detyruar të zbatojnë parimin e transparencës dhe jo diskriminimit".

Çmimet e ofertuara nuk janë çmimet reale të tregut, dhe i njëjti Operatorë ka bërë shkelje të rëndë duke ofertuar me çmime jashtëzakonisht të ulëta dhe manipulative si ato të ndara sipas Zonave, por veçanërisht tek ofertimi i çmemeve tek peshat, ku çmimi i ofertuar tek peshat më të mëdha është më i ultë se sa tek peshat më të vogla. Rrjedhimisht, sipas rregullave të Shërbimit Postar dhe standardeve të njohura për të gjithë për këtë shërbim, nuk mund të kemi çmim më të lirë për peshën 1.5-2.00kg se sa për peshën 0.5kg, ku i njëjti fakt edhe shihet në çmimin zyrtar të operatorit 3P shpk të cilën e ka dorëzuar më dosjen e tenderit Njoftimi nr. Prok. 216-23-13152-2-1-1, për fituesin 3P Sh.p.k., me çmim me të ultë 233.40 €, është marrë në kundërshtim me Nenin 59 dhe 60, pika 1.1 ku ka shpallur si tender fitues një tender i cili është i papërgjegjshëm, duke qenë se i njëjti nuk ka përmbushë kërkesat kyçe të kushteve që OE i cili ka ofertu ka qenë i obliguar të përmbushë në mënyrë që të kualifikohet si tenderues i përgjegjshëm në procesin e 7/3

F02 Formulari Standard për rishqyrtim të vendimit në AK vleresimit si dhe në kundërshtim me Nenin 61.6 të LPP-së dhe Neneve 3&4 të Rregullave të KRRP-ës B57, për shkak se çmimi i ofertuar nga 3P Shpk është jo normalisht i ulët dhe nuk është në përputhje me vlerën reale të shërbimeve të ofruara dhe në asnjë rast me këtë çmim të ofruar nuk mund të përmbillen dhe përmbushen obligimet kontraktuese

Sa i përket pretendimit nr.II të parashtruesit:

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ju njofton se bazuar në RROUP -Neni 41 duhet te plotësohen tri kushte :

Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;

ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;

iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë .

41.6 Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ultë sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Sikresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët".

Lidhur me pretendimin e II-te , Zyrtari përgjegjës i Prokurimit Konstaton se Komisioni ka mundur të kërkoj sqarime për çmimet Jonormalisht të Ulta .

Ndërsa për pretendimin tuaj se OE-ik i propozuar ka kontrate për vite të tera, ne ju njoftojmë se ky aktivitet është plublikuar si Procedurë e Hapur dhe çdo OE-ik mund të dorëzoj Ofertë.

Bazuar në sqarimet cekura më lart , Zyrtari Përgjegjës I prokurimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, konstaton se Kërkesa për Rishqyrtim e OE është pjesërisht e bazuar dhe vendos që lëndën ta kthej në Rivlerësim .

Komisioni i Rivlerësimit do të formohet me Vendim nga ZKA dhe gjatë rivlerësimit do të kërkoj sqarime për pikat e pretendimeve të OE-ik Ankues.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 13.02.2024

Kaltrina Dalipi



Ud. Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit Publik

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës / Ministarstvo Inostranih Poslova i Dijaspóra / Ministry of Foreign Affairs and Diaspora*

**NJOFTIM MBI VEDNDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: **Shërbimet postare Diplomatike-RITENDER RIVLERËSIM**

Nr. i prokurimit <sup>1</sup>	216-23-13152-2-1-1
-------------------------------	--------------------


Radhë	Lënda / grupi: Shërbimet postare Diplomatike-RITENDER	Çmimi total i ofertës(me TVSH) POENTIM
1.	3 P SH.P.K. Ahmet Krasniqi 254, Prishtinë 601168356	233.40
2.	A.L. DUSHI SH.P.K. KOSTA NOVAKOVIQ C4/2 LAM.B NR.5, PRISHTINE 811250860	1,304.55

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

AK shpërblen me kontratë A.L. DUSHI SH.P.K. me çmim me të lirë të përgjegjshëm prej 1,304.55

Data: 13.03.2024

Emri dhe mbiemri i  
Kaltrina Dalipi



<sup>1</sup> Da se izveštava u svakom dokumentu ili zahtevu u vezi sa aktivnost nabavke.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës / Ministarstvo Inostranih Poslova i Dijaspóra /  
Ministry of Foreign Affairs and Diaspora

Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm<sup>1</sup>

MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME, Rr. Luan Haradinaj Ndertesë e MPJ-së 10000  
PRISHTINË

A. L. DUSHI

Nr i Prokurimit	216-23-13152-2-1-1
Nr i brendshëm	

Titulli: Shërbimet postare Diplomatie-RITENDER

I/e nderuar(a) [Z/Znj].

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Kemi kënaqësinë të ju njoftojmë se ju keni dorëzuar [tenderin me çmimin më të ulët] si përgjigje ndaj [njoftimit të kontratës] për aktivitetin e prokurimit të lartcekur.

Juve ju është dhënë kontrata me çmimin e saktësuar në tenderin tuaj 1,304.55 ,dhe në pajtim me afatet dhe kushtet e dosjes së tenderit.

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimit të intervalit, gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.

Me respekt,  
Divizioni i Prokurimit Publik

<sup>1</sup> Kjo letër është për ofertuesin të cilit i është dhënë kontrata





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës / Ministarstvo Inostranih Poslova i Dijaspóra / Ministry of Foreign Affairs and Diaspora

Letër standarde për [tenderuesin] e eliminuar <sup>1</sup>

MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME, Rr. Luan Haradinaj Ndertesa e MPJ-së 10000 PRISHTINË

BP

Nr. i prokurimit:	216-23-13152-2-1-1
Nr i brendshëm	

Titulli: Shërbimet postare Diplomatiqe-RITENDER

I/e nderuar(a) [Z/Znj]/

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

[Tenderi juaj] është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në [dosjen e tenderit]. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

[Tenderi i juaj] është administrativisht e papërgjegjshme:

- Nuk i keni përmbushur kërkesat e sigurisë së tenderit;
- Nuk i keni plotësuar dhe nënshkruar si duhet [Formularin e paraqitjes së tenderit] [Formularin e paraqitjes së aplikacionit];
- Nuk i keni përmbushur kërkesat e vlefshmërisë së tenderit;
- Nuk e keni paraqitur numrin e mjaftueshëm të kopjeve të kërkuara;
- Nuk e keni paraqitur deklaratën e cila identifikon nënkontraktuesit e zgjedhur për aktivitetin relevant të prokurimit;
- Gabimi(et) aritmetikor i evidentuar(a) është më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës;
- Oferta e juaj, në përputhje me nenin 61.4 është konsideruar si oferte abnormalisht e ulët.  
X Nuk është përgjigjur kërkesës së AK për sqarime të çmimeve Abnormalisht të ulëta.

[Në rast të Grupit të Operatorëve Ekonomik]

<sup>1</sup> Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtejshme ngase kanë qenë të pa përgjegjshëm dhe të parregullt.

- Nuk keni paraqitur një deklaratë të qart se të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe, në rast se grupit i është dhënë kontrata, performancën e kontratës;
- Nuk keni paraqitur deklaratën e nënshkruar nga secili anëtar, e cila konfirmon pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër pjesëmarrës në procedurën e njejtë të prokurimit;
- Nuk keni paraqitur deklaratën e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit e cila autorizon partnerin udhëheqës të veprj në emër të grupit;
- Partneri juaj nuk i ka përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë.

*[Në rast të nënkontraktimit]*

- Nën-kontraktuesi (t) juaj nuk i ka përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë.

*[Tenderi i juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është i papërgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar:*

- Certifikatat apo dëshmitë e kërkuara të cilat tregojnë apo pohojnë se nuk jeni i diskualifikuar nga ndonjë masë nën Nenin 65 të LPP;
- Certifikatën, dokumentin ose ndonjë dëshmi tjetër të mjaftueshme të kërkuar sipas Nenit 66 të LPP për të dëshmuar përshtatshmërinë profesionale tuaj;
- Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenet 68 dhe 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbushni kërkesat minimale të gjendjes ekonomike dhe financiare dhe të kapacitetit teknik/profesional të saktësuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës.

## ARSYETIM

*[Ju jeni diskualifikuar ] për këto arsye :*

*Komisioni ka kërkuar sqarime për çmime abnormalisht të ulëta me datë 28.02.2024, dhe nuk jeni përgjigjur kërkesës së AK, andaj bazuar në RREGULLOREN Nr.001/2022 PER PROKURIMIN PUBLIKE -Neni 38 Sqarimi i tenderëve , pika 38.7 Nëse OE dështon të përgjigjet brenda afatit kohor të specifikuar nga AK sipas paragrafit 38.6 tenderi përkatës do të refuzohet.*

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

Me respekt,

PËR	<b>MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME DHE DIASPORËS</b>
NGA	<b>3P sh.p.k.</b> një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me numër unik identifikues 810842303 dhe seli në: Rruga “Ahmet Krasniqi”, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, e cila sipas autorizimit përfaqësohet nga Shoqëria e Avokatëve Sejdiu & Qerkini sh.p.k. <sup>1</sup> , me seli në: Lagja Veternik, Kompleksi Banesor EXDC3, Blloku 10, Kati 6, Nr. 18, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.
DATA	14 mars 2024
LËNDA	<b>KËRKESË për Rishqyrtim të Letrës standarde për tenderuesin e eliminuar nga tenderi nr. i prokurimit: 216-23-13152-2-1-1, datë 13.03.2024.</b>

## **I. Hyrje**

Autoriteti kontraktues, ka hapur tenderin me titull “Shërbimet Postare Diplomatike – RITENDER”, i cili identifikohet me numër të prokurimit: 216-23-13152-2-1-1. Në këtë tender të hapur kishte aplikuar edhe 3P sh.p.k. (këtu e tutje “Parashtruesi”).

Me datë 08.02.2024, Autoriteti Kontraktues, kishte marr vendimin me anë të së cilit si fitues të tenderit kishte shpallur Parashtruesin, i cili njëkohësisht ishte dhe është tenderuesi me çmimin dukshëm më të volitshëm.

**Provë 1: Njoftimi mbi vendimin dhe Letra standarde për tenderuesin e suksesshëm, datë 05.02.2024;**

I pakënaqur me këtë vendim dhe me njoftimin për eliminim, operatori ekonomik A.L.Dushi sh.p.k., paraqet kërkesë për rishqyrtim ndaj letrës së drejtuar asaj si tenderues i pasuksesshëm.

Autoriteti kontraktues, duke vendosur sipas kërkesës së operatorit ekonomik A.L.Dushi sh.p.k., me datë 13.02.2024, merr vendimin me anë të së cilit aprovon si pjesërisht të bazuar kërkesën e këtij operatori dhe tenderin e kthen në rivlerësim.

**Provë 2: Vendimi i Autoritetit Kontraktues, datë 13.02.2024;**

Duke vendosur në procedurë të rivlerësimit, Autoriteti kontraktues, me datë 13.03.2024, merr vendimin me anë të së cilit, fitues të tenderit e shpall operatorin ekonomik A.L.Dushi sh.p.k., ndërsa Parashtruesi është njoftuar se në këtë tender është tenderues i eliminuar.

**Provë 3: Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues;**

<sup>1</sup> Shih të bashkangjitur Autorizimin dhënë Shoqërisë së Avokatëve Sejdiu & Qekini sh.p.k

Parashtruesi nuk pajtohet me Letrën e Autoritetit Kontraktues (prova 3), ashtu që, në përputhje me këshillën juridike si dhe brenda afatit ligjor, paraqet këtë Kërkesë për Rishqyrtim të Letrës Standarde për tenderuesin e eliminuar, datë 13.03.2024, përmes së cilës të njëjtën e konteston në tërësi dhe e konsideron si tërësisht të pabazuar.

## **II. Baza Juridike**

Si bazë juridike, për hartimin dhe paraqitjen e kësaj kërkesë shërbeu:

- Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (këtu e tutje “LPP”);
- Ligji Nr. 04/L -237 për ndryshmin dhe plotësimin e Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (këtu e tutje “LPP I”);
- Ligji Nr. 05/L-068 për ndryshmin dhe plotësimin e Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (këtu e tutje “LPP II”);
- Ligji Nr. 05/L-092 për ndryshmin dhe plotësimin e Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (këtu e tutje “LPP III”);
- Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (këtu e tutje “LPPA”);
- Rregullore Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (këtu e tutje “Rregullorja”).

## **III. Arsyetimi**

### **3.1. Eliminimi i pabazuar**

Siç edhe është cekur në pjesën hyrëse të kësaj kërkesë, tenderi fillimisht ishte fituar nga ana e Parashtruesit. Ky proces ishte kthyer në rivlerësim nga ana e Autoritetit Kontraktues pas paraqitjes së Kërkesës nga një OE tjetër. Në vendimin për ta kthyer këtë çështje në rivlerësim, Autoriteti Kontraktues kishte cekur se nga Parashtruesi është mundur të kërkohen sqarime dhe atë: (i) dëshmitë nga shtetet, për çdo shtet nga 3 dëshmi dhe (ii) sqarim në lidhje me çmimet jo normalisht të ulëta.

Në përputhje me vendimin, Autoriteti Kontraktues, në të njëjtën ditë dhe në të njëjtën kohë, dërgon tek Parashtruesi këto 2 kërkesa për sqarim. Parashtruesi duke respektuar kërkesat e Autoritetit Kontraktues, përgatit kërkesa për sqarim dhe të njëjtat i bënë gati që ti ngarkojnë në sistemin e E-Prokurimit. Mirëpo, për shkak të një gabimi teknik, sqarimi për kërkesën e çmimit jo normalisht të ulët (ii) nuk qenka ngarkuar në sistemin e E- Prokurimit.

Sa i përket pjesës së gabimit teknik, për mos dërgim të sqarimit lidhur me çmime e ofertuara, theksojmë faktin se ende jemi pranë Autoritetit Kontraktues, pra kjo kërkesë shqyrtohet pranë të njëjtit Autoriteti i cili ka hapur tenderin dhe rrjedhimisht ende kemi të drejtë që të paraqesim sqarimin e kërkesës së paraqitur nga Autoritetit Kontraktues.



Pjesa e cekur në paragrafin e mësipërm gjen mbështetje edhe në dispozitat ligjore, paragrafi 1 i Nenit 1 të LPP-së, parasheh se:

*“1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.”*

Tutje, në Nenin 61 të LPP-së, i cili rregullon pjesën e Tenderit Jo – Normalisht të Ulët, në çdo fjali të këtij Neni, përmendet fjala Autoritet Kontraktues. Në një interpretim logjik dhe gjuhësor të paragrafëve të këtij Neni, rezulton se sqarimi mund të ofrohet në çdo fazë të përderisa rasti është duke u shqyrtuar pranë autoritetit kontraktues. Një shembull i thjeshtë i kësaj është se Autoriteti Kontraktues kur ka vendosur që çështjen ta kthej në rivlerësim (prova 2) ka vendosur në mënyrë procedurale, por që ka mundur që të paraqes kërkesën për sqarim tek Parashtruesi dhe pastaj vetë të vendos në mënyrë meritore. Kjo praktikë apo mënyrë e të vepruara, përveç që gjen mbështetje në dispozitat e cekura, mbështetet poashtu nga LPPA dhe LKA.

Andaj, Parashtruesi i cili gjatë gjithë këtij procesi ka vepruar në mirëbesim, në këtë Kërkesë për Rishqyrtim, paraqet sqarimi për çmimet më të ulëta sesa peshat e pakove.

Para se të dalim tek pjesa e sqarimit, Parashtruesi thekson faktin se ai është një ndër kompanitë më të njohura dhe më të suksesshme në botë, sa i përket shërbimeve postare dhe rrjedhimisht ka një rrjet tejet të madh të logjistikës që kësaj kompanie i mundëson dërgimin e ofertave që në krahasim me operatorët e tjerë, mund të duken si jo – normalisht të ulëta, por që në fakt ato janë oferta të vërteta dhe me anë të së cilave, Parashtruesi është zotuar dhe zotohet se do të përmbush tenderin.

Sqarimi:

“Është pjesë e politikës së DHL Express që për disa tregje të caktuara ku DHL Express operon dhe për klient të caktuar, të ofrojë çmime më të ulëta për disa nivele të peshave, si dhe për regjione të ndryshme.

Gjithashtu, vendimi i ofertimit të këtyre niveleve të çmimeve është në përputhshmëri me strategjinë e kompanisë në fokusin e targetimit të peshave të caktuara drejt destinimeve të caktuara, ku kompania parasheh potencial për rritje të volumeve të dërgesave.

Çmimet e ofertuara në Tender janë bërë bazuar në ekspertizën e DHL Express, sipas standardeve të operimit, si dhe duke përmbushur normën e dërgesave mujore, për llogari exporti dhe importi.



DHL Express siguron që me çmimet përbërëse të Ofertës Financiare të dorëzuar në tender, do të realizohet i gjithë tenderi, dhe se nuk do të ketë asnjë vonesë apo mospërbushje, përderisa këto çështje janë nën kontroll të Parashtruesit. Poashtu ky Operator Ekonomik, siguron se gjatë çdo veprimi që ndërmerret, përfshirë këtu edhe aplikimet për tender, përveç që synon fitimin afarist siç bënë çdo subjekt ekonomik, synon edhe mbrojtjen e emrit të saj dhe të pjesës së çfarë DHL përfaqëson, si një brend i besueshëm dhe global, ashtu që natyrisht se krahas shërbimit profesional edhe çmimet e ofruara do të mbesin të pandryshueshme përgjatë tërë validitetit të kontratës.”

Në vazhdim dhe përsëri në ndërlidhje me paragrafin 1 të Nenit 1 të LPP-së “*Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike..*”, theksojmë në rast se nuk do të merret parasysh oferta e Parashtruesit, në rastin konkret do të vinte në shprehje keqpërdorimi i fondeve publike apo në rastin më të butë shfrytëzimi jo i drejtë i tyre, sepse Autoriteti Kontraktues, do të zgjidhte një operator ekonomik, i cili është TEJET më i shtrenjtë sesa Parashtruesi dhe rrjedhimisht do të dëmtohej buxheti i shtetit, si dhe poashtu nuk do të realizohej vetë qëllimi i ligjit. Krahas këtyre nuk do të realizohej as vetë tenderi i cili si fitues është dashur të jep operatorin me çmimet më të ulëta, e që në rastin konkret subjekti juridik më i njohur në botë për çështje të dërgesave postare DHL, ofron çmimet më të ulëta. Pra, Autoriteti Kontraktues këtu ka mundësinë, e në bazë të shkresave të lëndës edhe obligimin që për çështjet e dërgesave postare të bashkëpunoj me më të mirin i cili njëkohësisht rezulton të jetë edhe më i liri – 3p sh.p.k distributori i autorizuar i DHL.

#### **IV. Përfundimi dhe Kërkesa**


Bazuar në dispozitat ligjore, argumentet, sqarimin e ofruar si dhe provat e bashkangjitura në këtë Kërkesë, vërtetohet se Parashtruesi çdo veprim të ndërmarr e ka bërë me mirëbesim dhe poashtu vërtetohet se është operatori ekonomik dukshëm më i lirë. Andaj, bazuar në të gjitha këto, Parashtruesi me respekt, Autoritetit Kontaktues i propozon të bie këtë:

## VENDIM

- I. **APROVOHET** Kërkesa e 3P sh.p.k për Rishqyrtim të Letrës Standarde për Tenderuesin e Eliminuar, e nxjerr nga Autoriteti Kontraktues Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, datë 13.03.2024, drejtuar 3P sh.p.k, sa i përket tenderit të identifikuar si: 216-23-13152-2-1-1, si e **BAZUAR**;
- II. **ANULOHET** Letra Standarde për Tenderuesin e Eliminuar, e marrë nga Autoriteti Kontraktues Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, datë 13.03.2024, drejtuar 3P sh.p.k. si e **KUNDËRLIGJSHME**;
- III. 3P sh.p.k. **SHPALLET TENDERUES I SUKSESSHËM** sa i përket aktivitetit të prokurimit 216-23-13152-2-1-1.

Kërkesa për rishqyrtim e hartuar dhe paraqitur me respekt nga:

*Shoqëria e Avokatëve  
Sejdiu & Qerkini sh.p.k.*



*Avokat Burim Azemi*



**SEJDIU &  
QERKINI**  
SHOQËRIA E AVOKATËVE  
SH.P.K.

Prishtinë, 15 mars 2024



**SEJDIU & QERKINI**

SHËRËZIM I AVOKATËVE  
GJYKIMOR

**Burim Azemi <burim.azemi@sq-law.com>**

---

**RE: Njoftim**

2 messages

**Artan Metaj** <artan.metaj@3plog.net>

To: Kaltrina Dalipi <Kaltrina.Dalipi@rks-gov.net>

Cc: Behar Isma <Behar.Isma@rks-gov.net>, Zyra e Sekretarit në MPJD <zsp.mpjd@rks-gov.net>, Burim Azemi <burim.azemi@sq-law.com>

Fri, Mar 15, 2024 at 5:05 PM

Pershendetje Kaltrina,

Faleminderit pe njoftimin. Kerkesen per rishqyrtim tani e kemi aplikuar edhe sipas rregullores ne Fjale.

Me respekt

Artani

---

**From:** Kaltrina Dalipi <Kaltrina.Dalipi@rks-gov.net>

**Sent:** Friday, March 15, 2024 2:51 PM

**To:** Artan Metaj <artan.metaj@3plog.net>

**Cc:** Behar Isma <Behar.Isma@rks-gov.net>; Zyra e Sekretarit në MPJD <zsp.mpjd@rks-gov.net>

**Subject:** Njoftim

I nderuar

Kërkesën tuaj për rishqyrtim duhet ta paraqitni sipas Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik Neni 59 dhe 60.

Me respekt

Kaltrina

3/26/24, 10:57 AM

E-Prokurimi

e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=327

EBSCO Gmail Maps NLB E-Prokurimi AllForward OpenAI API Chat Open AI Turnitin MBA Launch Page

Shitjet e mia të preferuara

Tenderët

Kërkesat për pjesëmarrje

kërkesat për sqarime TD

Kërkesat për rishqyrtim

Ankesa

MENAXHIMI I KONTRATES

ANKANDET REVERSE

ANKANDET

NJOFTIMET - PROKURIMET

NJOFTIMET - SHITJE

KONTRATAT E DHËNA

MARRËVESHJET KORNIZË E DHËNA

KLASIFIKIMI LIGJOR

TE DHËNAT E MIA

MESAZHET

FPP fjaliori kryesor

Statusi

Njoftimet

Dosja e tenderit

Dokumenti shtojca

Sqarimet e DT

Oferat

Kërkesat për rishqyrtim

Dokumentet - Letrat standarde

Proces verbali. Vendimi B58

Dokumentet lidhur me kontratat

6400000-06 Shërbime postare dhe të telekomunikacionit

### Kërkesat për rishqyrtim

**Kërkesë për rishqyrtim**

Kërkesë për rishqyrtim - Kërkesë për Rishqyrtim të Letres standarde për Tenderuesin e Eliminuar nga Tenderi Nr 216-23-13152-2-1, date 13.03.2024 Gjени te bashkangjitur kërkesen  
Kodi i dokumentit:

Hape: [Shqip](#)

15.03.2024 15:54

**Dokumenti Shtojca**

15.03.2024 15:59 2024-03-15-3P-Kërkesa për Rishqyrtim.pdf

Hape: [Shqip](#)

**Kërkesë për rishqyrtim**

Kërkesë për rishqyrtim - Japne te pershkruara ne detaje ne kërkesen per rishqyrtim te aktivitet te Prokurimit 216-23-13152-2-1-1, date 13.03.2024  
Kodi i dokumentit:

Hape: [Shqip](#)

15.03.2024 16:13

**Dokumenti Shtojca**

15.03.2024 16:13 2024-03-15-3P-Kërkesa për Rishqyrtim.pdf

Hape: [Shqip](#)

Dërguar nga : **MINISTRIA E PUNEVE TË JASHTME**  
Vendimi i AK ne Kërkesen per rishqyrtim  
Vendimi per OE aidushi.pdf

Hape: [Shkarko të gjithë dokumentacionin](#) [Dokument PDF](#)

13.02.2024 13:21



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës*  
*Ministarstvo Inostranih Poslova i Dijaspore - Ministry of Foreign Affairs and Diaspora*

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik 3P SHPK të datës 15.03.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 13.03.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet postare Diplommatike-RITENDER" me nr. të prokurimit 216-23-13152-2-1-1, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik 3P SHPK. e datës 15.03.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 13.03.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet postare Diplommatike-RITENDER" me nr. të prokurimit 216-23-13152-2-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik 3P SHPK si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

- V. Operatori ekonomik 3P SHPK (tutje "parashtruesi") me datë 15.03.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 13.03.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet postare Diplommatike-RITENDER" me nr. të prokurimit 216-23-13152-2-1-1.
- VI. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa nuk është e lejuar sepse OE "3P SHPK" ka dorëzuar një kërkesë përmes



funksionit "dorezimi i dokumenteve shitesë" e jo sipas dispozitave ligjore-NENI 59.2 dhe NENI 60.1.

*60.1 Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë të dhënat në pajtim me formularin F02 dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksioni " kërkesat për rishqyrtim "*

*59.2 Formularët standard mund të shkarkohen nga ueb faqet e KRPP-së dhe OSHP-së*

*a. Formulari F01 Formulari Standard për parashtrimin e ankesës në OSHP*

*b. Formulari F02 Formulari Standard për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues*

Gjithsesi Zyrtari Përgjegjës I Prokurimit duke u bazuar në:

*61.2 Nëse mungon ndonjë nga elementet e përmendura nën nenin 60.2 të kësaj rregullore, Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do të kërkojë nga aplikuesi që të plotësojë kërkesën e tij brenda një periudhe jo më të gjatë se dy (2) ditë nga marrja e kërkesës. Nëse parashtruesi i kërkesës nuk vepron sipas kërkesës së lartpërmendur, kërkesa për rishqyrtim do të refuzohet si e paplotë.*

Më datë 15.03.2024, përmes plafromës së EPROKURIMIT po ashtu edhe përmes Emalit Zyrtar, ka njoftuar OE -ik se kërkesa për rishqyrtim duhet të dorëzohet sipas dispozitave Ligjore Neni 59.1 dhe 59.2 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik si dhe Neni 60 Paraqitja e kërkesës për rishqyrtim dhe afatet kohore 60.1. Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë të dhënat në pajtim me formularin F02 dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksioni " kërkesat për rishqyrtim ".

Edhe pas njoftimit nga ana ZPP, OE-ik nuk ka dorëzuar Kërkesën sipas udhëzimeve.

**Pretendimi nr.I i parashtruesit është cituar si në vijim:**

*"Eliminimi e Papazuar" nga ana e Autoritetit Kontraktues, për sqarimet ofruara nga ana e OE.*

**Sa i përket pretendimit të parashtruesit**

Autoriteti Kontraktues me datë 28.02.2024, ka dërguar dy kërkesa për sqarime OE-ik 3P SHPK:

1.Leter standarde për sqarime shitesë për kërkesën e kapacitetit teknik (1. Na dorëzoni dëshmitë sipas kërkesës: Dëshmi (AWB) ku dëshmohet që për disa shtete të caktuara p.sh Evropë (Gjermania, Franca) ka bërë realizimin e dërgesave për 24 orë, Azi (2 shtete) ka bërë realizimin e dërgesave për 48-72 orë, Afrike (2 shtete) ka bërë realizimin e dërgesave për 48-72 orë

dhe SHBA & Canada ka bere realizimin e dërgesave për 36-48 or, D.m.th. për çdo shtet nga 3 dëshmi (original) -

Duhet cekur se OE-ik është deklaruar lidhur me kërkesën e sqarimeve për AWB(cdo shtet nga tri dëshmi) por edhe pas sqarimeve të dorëzuara nga ana e OE-ik , nuk e plotësojnë kërkesën e Autoritetit Kontraktues ( sepse shumica e tyre janë pas datës së hapjes së Ofertave.

2.Letër standarde për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët (Një zbërthim të detajuar të pjesëve relevante të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë)

OE-ik"3P SHPK" plotëson të gjitha kushtet për tu konsideruar si tender jo normalisht i ulët, andaj bazuar në NENIN 41, Pika 41.6 dhe ka kërkuar sqarime për të njëjtat por Autoriteti Kontraktues nuk ka pranuar pergjigje nga OE-ik lidhur me kërkesën e arsytimitin e cmimeve

*Në mometin që OE"3P SHPK" kthen përgjigje lidhur me dëshmit (AWB) dhe nuk deklarohet për cmime abnormale, bie nën kundërshtim me arsytimitin e cekur në ankesë se ishte "gabim teknik".*

Autoriteti Kontraktues me të drejt ka refuzuar OE-ik , sepse nuk është deklaruar lidhur me kërkesën e AK (Neni 38 Sqarimi i tenderëve , pika 38.7 Nëse OE dështon të përgjigjet brenda afatit kohor të specifikuar nga AK sipas paragrafit 38.6 tenderi përkatës do të refuzohet.)

#### Neni 41 Tenderët Jo-normalisht të Ulët

41.3 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme :

i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;  
ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;  
iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

41.4 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 41.3 të kësaj rregullore, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tillë dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përpulhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së.

41.5 Kur një tender konsiderohet si jo normalisht i ultë në pajtim me Nenin 61 të LPP dhe paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një tender i tillë nuk mund të refuzohet pa hetimin dhe shqyrtimin e elementeve të rëndësishme që shkaktoj tenderin veçanërisht të ulët.

41.6 Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ultë sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e

ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët".

*41.7 Operatori Ekonomik do t'i përgjigjet me shkrim Autoritetet Kontraktues. Nëse jo, tenderi do të refuzohet.*

*Bazuar ne Piken 41.7 te rregullores po ashtu edhe Neni 38 Sqarimi i tenderëve , pika 38.7 Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit konfirmon se OE -ik "3P SHPK" është i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të Prokurimit.*

Pas trajtimit të kërkesës për rishqyrtim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme dhe nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar pretendimet e tij. Po ashtu nga provat e administruara nuk është arritur që të vërtetohen pretendimet e parashtruesit në kuptim të nenit 62 paragrafit 62.1 nënparagrafi d) të Rregullores (A01) nr.001/2022 për Prokurimin Publik (tutje "RRPP").

Prandaj komisioni vlerësues me të drejtë ka rekomanduar refuzimin e tenderit dhe kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.


Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 20.03.2024

Kaltrina DALIPI



Ud. Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit Publik



**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.